

Vendim nr. 74 datë 22.10.2024

(V-74/24)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimimi, Marjana Semini, Sonila Bejtja, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 22.10.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 17 (Sh) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **SHOQËRIA “TIRANA AUTO” SH.P.K.**, e përfaqësuar nga administratori Benon Dede.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT, e përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm, Muhamet Rrumbullaku.

ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT “EGH” SH.P.K., në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 172, datë 04.07.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2023-4875, datë 22.11.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, si dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (*DPPSH*), i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit tjetër të interesuar, zyrës së përbarimit privat “EGH” sh.p.k., si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësja, shoqëria “Tirana Auto” sh.p.k., dhe subjekti i interesuar, DPPSH-ja, janë palë në kontratën nr. 17/4, datë 19.06.2017, me objekt “*Marrje mjetesh me qira operationale për Policinë e Shtetit*”, të lidhur për një afat 4-vjeçar, kontratë e cila është amenduar në datën 11.04.2018. Pas përfundimit të kontratës, kërkuësja ka lëshuar dy fatura tatimore elektronike shitjeje, nr. 44, datë 23.08.2021 dhe nr. 45, datë 25.08.2021. Në vijim, duke qenë se detyrimi sipas këtyre faturave nuk është përmbushur, kërkuësja i është drejtuar gjykatës me kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2146, datë 25.01.2022, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për titujt ekzekutivë fatura tatimore elektronike shitjeje nr. 44, datë 23.08.2021 në shumën 1,008,498 lekë dhe nr. 45, datë 25.08.2021, në shumën 227,168,428 lekë, duke ngarkuar shërbimin përbarimor gjyqësor për ekzekutimin e tyre (*urdhri gjyqësor i ekzekutimit*). Në vendimin e saj, për arritjen në përfundimin se faturat tatimore elektronike të shitjes në fjalë janë tituj ekzekutivë, ajo gjykatë i është referuar nenit 16 të ligjit nr. 48/2014 datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara të detyrimeve kontraktore e tregtare”, të ndryshuar (*ligji nr. 48/2014*). Pika 1 e këtij neni parashikon se detyrimet monetare, të lindura nga veprimet juridike tregtare, të cilat nuk janë shlyer brenda afatit të pagesës përkatëse, sipas këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 485 i Kodit Civil, përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen në ekzekutim nga përbaruesi gjyqësor, pavarësisht vlerës kur: (a) kreditori ka lëvruar mallrat apo kryer shërbimet sipas kontratës dhe ligjit; (b) debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin.

2. Kërkuësja, në cilësinë e kreditorit, ka vënë në lëvizje procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë sipas urdhrit gjyqësor të ekzekutimit dhe me shkresën nr. 1049, datë 01.08.2022, përbaruesi gjyqësor privat ka lajmëruar palën debitore, DPPSH-në dhe Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë (*DVP, Tiranë*), për ekzekutimin vullnetar të detyrimit (*lajmërimi për*

ekzekutimin vullnetar të detyrimit). Në vijim, në lidhje me ekzekutimin, pala debitore ka përdorur mjetet mbrojtëse nga ekzekutimi, duke vënë në lëvizje disa procese gjyqësore.

i) Procesi i parë gjyqësor

3. Në datën 08.08.2022, pasi është njohur me lajmërimin për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, DPPSH-ja i është drejtuar gjykatës me padi me objekt pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, kundërshtimin e veprimit përmbartimor të lajmërimit për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, si dhe ka kërkuar edhe marrjen e masës paraprake të pezullimit të ekzekutimit. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin e datës 13.09.2022, ka vendosur refuzimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit. Ndaj këtij vendimi nuk rezulton dhe as referohet të jetë paraqitur ankimi i veçantë. Ndërkohë, për themelin e çështjes, me vendimin nr. 2821 (80-2022-2868), datë 26.10.2022, ajo gjykatë ka vendosur mospranimin e padisë, me arsyetimin se DPPSH-ja nuk legjitimohej për ngritjen e saj, pasi nuk ishte pala debitore sipas titujve ekzekutivë, faturave tatimore elektronike të shitjes nr. 44, datë 23.08.2021 dhe nr. 45, datë 25.08.2021, si dhe amendimeve të kontratës publike të lidhur me palëve, ku si e tillë paraqitej DVP-ja, Tiranë. Mbi bazën e ankimit të DPPSH-së, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 86-2023-832, datë 25.09.2023, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë dhe kthimin e çështjes për vazhdimin e gjykimit në po atë gjykatë. Deri në momentin e gjykimit kushtetues, gjykata e shkallës së parë ende nuk kishte dhënë vendim për këtë çështje.

ii) Procesi i dytë gjyqësor

4. Në datën 23.06.2023 debitorët, DPPSH-ja dhe DVP-ja, Tiranë, kanë kundërshtuar në gjykatë veprimin përmbartimor të përlllogaritjes së kamatëvonesave ligjore sipas vendimit nr. 1465 prot., datë 15.06.2023 të përmbartuesit gjyqësor. Edhe në këtë rast debitorët kanë kërkuar marrjen e masës paraprake të pezullimit të ekzekutimit, për të cilën Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin e datës 27.06.2023, ka vendosur rrëzimin e saj, duke vlerësuar, bazuar në përmbajtjen e nenit 29 të ligjit nr. 49/2012, datë 05.03.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*), që parashikon kushtet dhe kriteret për vendosjen e masës së sigurimit të padisë, se kërkuuesi nuk ka provuar dëmin e rëndë dhe të parikuperueshëm në të ardhmen dhe as natyrën e dëmit, dhe se ajo çka është kërkuar përmes kësaj mase është e njëjtë me atë që kërkohet në themel të kërimit. Ndaj këtij vendimi nuk rezulton dhe as referohet të jetë paraqitur ankimi i veçantë. Ndërkohë, për themelin e çështjes, me vendimin nr. 368 (80-2024-355), datë 12.02.2024, ajo gjykatë ka vendosur pranimin e ankimit, duke shfuqizuar

veprimin përbarimor të përlllogaritjes së kamatëvonesave ligjore sipas vendimit nr. 1465 prot., datë 15.06.2023 të përbaruesit gjyqësor. Sipas gjykatës, përbaruesi gjyqësor kishte vepruar me iniciativë, duke caktuar ekspert për përlllogaritjen e kamatëvonesave, në një kohë kur në asnjë nga pikat e dispozitivit të urdhrit gjyqësor të ekzekutimit nuk është disponuar për detyrimin e debitorit për pagimin e kamatëvonesave dhe kjo nuk është parashikuar as në pjesën arsyetuese të vendimit. Sipas saj, nëse do të donte të vinte në ekzekutim së bashku me detyrimin edhe kamatëvonesat, kreditori duhej të kërkonte plotësimin e vendimit. Kundër këtij vendimi është paraqitur ankim.

iii) Procesi i tretë gjyqësor

5. Në datën 26.06.2023, ndërsa procesi i parë gjyqësor ndodhej në gjykatën e apelit dhe procesi i dytë gjyqësor sapo kishte filluar në gjykatën e shkallës së parë, debitori, DPPSH-ja, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesë për pezullimin e ekzekutimit. Sipas debitorit, pavarësisht se çështja e vlefshmërisë së titujve ekzekutivë dhe ajo e ligjshmërisë së veprimit përbarimor të përlllogaritjes së kamatëvonesave ligjore, sipas vendimit nr. 1465 prot., datë 15.06.2023 të përbaruesit gjyqësor, ishin në proces gjykimi respektivisht përpara gjykatës së apelit dhe gjykatës së shkallës së parë, përbaruesi gjyqësor po vijonte veprimet përbarimore duke përlllogaritur në kundërshtim me ligjin edhe kamatëvonesa të tjera ligjore. Me vendimin nr. 172, datë 04.07.2023, gjykata e apelit ka vendosur pranimin e kërkesës, duke urdhëruar pezullimin e veprimeve përbarimore për ekzekutimin e titullit ekzekutiv sipas urdhrit gjyqësor të ekzekutimit. Sipas asaj gjykate, ajo e merrte kompetencën për shqyrtimin e kërkesës nga neni 28, pika 4, i ligjit nr. 49/2012, ndërsa për themelin e kërkesës i referohej neneve 609 dhe 610 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Sipas gjykatës së apelit, për sa kohë vlefshmëria e titullit ekzekutiv ishte në gjykim (referuar procesit të parë gjyqësor), nisur nga natyra e këtij detyrimi që lidhej me efekte financiare të konsiderueshme për buxhetin e shtetit dhe interesin publik që duhej mbrojtur dhe garantuar në çdo rast, kërkesa për pezullimin e ekzekutimit ishte e bazuar. Kundër këtij vendimi kërkesja ka paraqitur rekurs të veçantë.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-4875, datë 21.11.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses. Sipas tij, konkluzioni i gjykatës së apelit ishte i drejtë, për sa kohë vlefshmëria e titullit ekzekutiv ishte në gjykim dhe rreziku eminent, si dhe për sa kohë ky titull përmbante detyrime financiare që lidheshin me efekte financiare të konsiderueshme në buxhetin e shtetit, duke qenë kështu në kushtet e cenimit edhe të interesit publik.

7. Në datën 22.05.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore të dhëna në procesin e tretë gjyqësor, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 28.05.2024.

8. Kolegji i Gjykatës në datën 28.06.2024, bazuar në nenin 31, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, vendosi kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, ndërsa kjo e fundit në datën 08.07.2024 vendosi kalimin e çështjes në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e *së drejtës së pronës* sipas nenit 41 të Kushtetutës, për shkak të zhvillimit të një procesi jo të rregullt në drejtim të:

9.1. *Parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi në rastin konkret nuk jemi thjesht përpara një vendimi të formës së prerë, por edhe përpara një gjykimi që lidhet me lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, për të cilin nuk nevojitet një gjykim themeli. Kërkesa për pezullim, si një mjet i jashtëzakonshëm, duhet të arsyetohet rast pas rasti dhe jo me arsytetime standarde, ku përmenden disa parime të përgjithshme. Në rastin konkret, gjykatat duhet të kishin arsyetuar përse dëmi është i pakthyeshëm në rastin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv, përse cenohet interesi publik dhe përse kërkuesja, nëse do të rezultonte gjyqëmbësore, nuk ka kapacitete për të kthyer mbrapsht shumat monetare etj., duke e lidhur arsyetimin me rrethanat e kërkueses dhe marrëdhënien konkrete kontraktore.

9.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit*, pasi gjykatat nuk kanë saktësuar nëse çështja ka të bëjë me sigurimin e padisë në gjykimin administrativ, që shqyrtohet sipas neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 49/2012, të cilat janë *lex specialis* për nenet 202 e vijues të KPC-së apo me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv dhe kundërshtimin e veprimeve përmbartimore, që rregullohet nga nenet 609 dhe 610 të KPC-së. Për rrjedhojë, duke mos përcaktuar qartë bazën ligjore, vendimet e kundërshtuara janë të paqarta. Edhe duke marrë të mirëqenë bazën ligjore të përcaktuar nga DPPSH-ja, nenin 610 të KPC-së, kompetente për shqyrtimin e kërkesës për pezullim për herë të parë do

të ishte gjykata e shkallës së parë dhe jo ajo e apelit, ndërkohë që gjykatat nuk kanë arsyetuar se si janë ato kompetente nga pikëpamja lëndore. Dispozitat e referuara nga gjykatat (nenet 28 dhe 29 të ligjit nr. 49/2012) në fakt mbrojnë individin ndaj shtetit dhe jo e kundërta.

9.3. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi kërkesja nuk ka pasur dijeni për procesin e zhvilluar në Gjykatën Administrative të Apelit, duke mos pasur mundësi të paraqesë argumente e rrethana lidhur me çështjen. Gjykata e apelit në marrjen e vendimit është bazuar vetëm te kërkesa e DPPSH-së. Duke qenë se edhe në Gjykatën e Lartë çështja është gjykuar në dhomën e këshillimit, kërkesja nuk kishte asnjë mundësi që të mbrohej.

9.4. *Parimit të barazisë përpara ligjit*, pasi në rastin konkret Gjykata e Lartë e ka trajtuar kërkesën ndryshe nga çka trajtuar palë të tjera në raste të ngjashme. Në këtë rast gjykatat kanë tentuar ta klasifikojnë çështjen si kërkesë për sigurim padie sipas neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 49/2012. Ndërkohë, vetë Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në një rast tjetër të shqyrtuar me vendimin nr. 00-2016-907 (112), datë 31.03.2016, ka mbajtur qëndrimin se kjo përbën cenim të kompetencës lëndore, duke i konsideruar sigurimin e padisë dhe pezullimin e ekzekutimit të një titulli ekzekutiv si koncepte të ndryshme që nuk mund të njësohen me njëra-tjetrën.

10. ***Subjekti i interesuar, DPPSH-ja***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:
i. Për legjitimitimin

10.1. Kërkesja nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës, pasi në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës ajo nuk konsiderohet individ dhe, gjithashtu, nuk ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen konkrete. Po kështu, kërkesja nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion, pasi një pjesë të pretendimeve të saj nuk i ka paraqitur në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Nga ana tjetër, vendimi i kundërshtuar nga kërkesja nuk konsiderohet përfundimtar për efekte të gjykimit kushtetues, pasi është një vendim i ndërmjetëm për pezullimin e veprimeve përmbartimore dhe, si i tillë, referuar jurisprudencës kushtetuese, nuk mund të kundërshtohet në këtë Gjykatë pa përfunduar gjykimi i themelit. Edhe në drejtim të pretendimeve të parashtruara, kërkesja nuk ka paraqitur asnjë argument kushtetues për të mbështetur ato.

ii. Për themelin

10.2. Pretendimi i kërkueses për cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor* është haptazi i pabazuar, pasi forma e arsytimit të Kolegjit Administrativ shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit gjatë shqyrtimit paraprak në dhomën e këshillimit dhe nuk paraqet ndonjë mangësi, e cila ka ndikuar negativisht në të drejtën e kërkueses për proces të rregullt ligjor.

10.3. Të pabazuara janë edhe pretendimet në drejtim të *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe parimit të sigurisë juridike*, të lidhura me *standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit të paraqitur ndaj vendimit për pezullimin e veprimeve përmbartimore është i arsytuar dhe është marrë në zbatim të drejtë të ligjit dhe në përputhje me të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, si dhe parimin e sigurisë juridike.

11. *Subjekti i interesuar, zyra e përmbartimit privat "EGH" sh.p.k.*, nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim edhe pse është njoftuar nga Gjykata.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkueses

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "F" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13. Kërkuesja ka pretenduar se plotëson të gjitha kriteret kushtetuese dhe ligjore të legjitimitimit, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "F", të Kushtetutës, duke pasur parasysh, gjithashtu, se në jurisprudencën kushtetuese vendime të tilla janë konsideruar me natyrë përfundimtare.

14. Subjekti i interesuar, DPPSH-ja, e ka kundërshtuar legjitimitimin e kërkueses në tërësi, duke prapësuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "F", të Kushtetutës: kërkuesja

nuk konsiderohet individ; nuk ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen konkrete; nuk janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion, pasi një pjesë e pretendimeve nuk janë paraqitur në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë; vendimi i kundërshtuar nuk konsiderohet përfundimtar për efekte të gjykimit kushtetues, pasi është një vendim i ndërmjetëm për pezullimin e veprimeve përmbartimore dhe, si i tillë, nuk mund të kundërshtohet në këtë Gjykatë pa përfunduar gjykimi i themelit; kërkuësja nuk ka paraqitur argumente kushtetuese për të mbështetur pretendimet e parashtruara.

15. Gjykata vëren, fillimisht, se objekt i ankimit kushtetues individual është vendimi i ndërmjetëm për pezullimin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë i dhënë në procesin gjyqësor të vënë në lëvizje nga subjekti i interesuar DPPSH-ja (pala paditëse). Në këtë proces gjyqësor kërkuësja ka pasur cilësinë e palës së tretë, e cila është edhe pala që ka vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë përmes rekursit. Për rrjedhojë, në drejtim të legjitimitetit *ratione personae* të kërkuëses, kjo e fundit jo vetëm ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, por ajo mbart edhe interes të drejtpërdrejtë në këtë çështje, për sa kohë pezullimi i ekzekutimit sjell si pasojë ndërprerjen e ekzekutimit normal të titujve ekzekutivë për të cilët është lëshuar urdhri gjyqësor i ekzekutimit, tituj këta që mbartin të drejta pasurore për kërkuësen. Pra, kërkuësja legjitimohet *ratione personae* qoftë në aspektin procedural, ashtu dhe në atë substancial.

16. Për sa i përket pretendimit të DPPSH-së se kërkuësja nuk është individ në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se sipas nenit 16 të Kushtetutës të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të tyre dhe me thelbin e këtyre të drejtave e lirive. Kërkuësja është person juridik i krijuar sipas legjislacionit shqiptar dhe ajo ka vënë në lëvizje gjykimin kushtetues për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese të pretenduara të cenuara, për të cilat Kushtetuta ofron të njëjtën mbrojtje si për personat fizikë. Për rrjedhojë, kërkuësja legjitimohet *ratione persone* ndaj pretendimet e subjektit të interesuar, DPPSH-së, në këtë drejtim janë të pabazuara.

17. Për sa i përket kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Cenimi i të drejtave themelore mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojné në një rëndim të mëtëjshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte. Ky rregull, në thelb, synon t’u japë organeve publike

dhe në veçanti gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit (*shih vendimet nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Për sa u përket kritereve që duhet të plotësojë një vendim i ndërmjetëm në mënyrë që të konsiderohet përfundimtar, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata ka përcaktuar se ai: (i) duhet që të ketë vendosur një kufizim mbi të drejtën e individit të pretenduar të cenuar, pra që shkelja e pretenduar të jetë pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm të kundërshtuar, që do të thotë se kërkuesi duhet të provojë se është viktimë e shkeljes të së drejtës kushtetuese; (ii) duhet të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe të jetë shqyrtuar edhe nga gjykatat më të larta, të cilat të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; (iii) duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm, në kuptimin që të riparohet në masën e duhur efektet që ai ka sjellë. Kjo do të thotë se cenimi është në atë masë dhe formë që pasojat e ardhura është e vështirë ose e pamundur të riparohen gjatë procesit të themelit (*shih vendimet nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Referuar edhe praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), për të përcaktuar nëse ndodhet para një rasti përjashtimor të zbatimit të nenit 6 të *KEDNJ*-së, vlerësohet nëse karakteri i masës së ndërmjetme e kërkon këtë, pra kur ajo ka qenë drastike, ka vendosur për padinë kryesore në një masë të konsiderueshme dhe kur, përveçse nëse është shfuqizuar/hequr nga një gjykatë më e lartë, ka prekur të drejtat e palëve për një periudhë kohe të konsiderueshme (*shih Markass Car Hire Ltd kundër Qipros, nr. 51591/99, datë 23 tetor 2001; Micallef kundër Maltës, datë 15 tetor 2009, paragrafët 78 - 80*).

20. Në këtë kuptim, duke qenë se objekt i ankimit kushtetues individual është vendimi i ndërmjetëm gjyqësor që ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë, Gjykata vlerëson të ritheksojë se ajo nuk vë në dyshim karakterin e ndërmjetëm të këtyre lloj vendimesh dhe as nuk synon të largohet nga jurisprudenca e saj e deritanishme, sipas së cilës vetëm vendimet gjyqësore përfundimtare mund t'i nënshtrohen kontrollit të saj. Përkundrazi, duke zhvilluar jurisprudencën e saj në drejtim të identifikimit të rasteve përjashtimore, në të cilat garancitë kushtetuese shtrihen edhe mbi një listë të kufizuar vendimesh të ndërmjetme, Gjykata synon të bëjë sa më efektive mbrojtjen kushtetuese që ofron ankimi kushtetues individual, në përputhje edhe me jurisprudencën e *GJEDNJ*-së.

21. Duke pasur parasysh standardet e mësipërme, Gjykata në rastin konkret do të ndalet në verifikimin nëse ndodhet përpara një rasti përjashtimor që lejon kontrollin kushtetues të vendimeve objekt kërkese, pra nëse ato kanë cenuar të drejta kushtetuese të kërkueses, të cilat janë bërë objekt shqyrtimi në të gjitha shkallët e juridiksionit të zakonshëm dhe nëse ajo (kërkuesja) ka arritur të provojë se pasojat në këto të drejta janë të tilla që, për nga rëndësia dhe masa e tyre, është e pamundur të riparohen gjatë gjykimit të themelit të çështjes. Në drejtim të riparueshmërisë së të drejtave kushtetuese të cenuara, Gjykata do të analizojë kohëzgjatjen e pezullimit.

22. Gjykata vëren se objekt i ankimit kushtetues individual është procesi gjyqësor i përmbyllur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në të cilin janë dhënë vendimet që kanë pezulluar ekzekutimin e titujve ekzekutivë, pikërisht të faturave tatimore të shitjes të lëshuara gjatë zbatimit të një kontrate të nënshkruar me vullnetin e palëve, të cilat janë vlerësuar nga gjykata si akte me fuqi ekzekutive në kuptim të ligjit të posaçëm nr. 48/2014. Për rrjedhojë, kërkuesja është penguar të ekzekutojë detyrimet monetare sipas titujve ekzekutivë, të cilat përfshihen në konceptin e së drejtës substanciale të pronës private, për sa kohë që edhe pagesa e një sasive të caktuar të hollash është një shumë që merret nga pasuria e individit (*shih vendimet nr. 15, datë 22.06.2022; nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, duke qenë se kërkuesja është një person juridik, dhe duke mbajtur në konsideratë se e drejta e pronës është element i lirisë së veprimtarisë ekonomike, si aftësi e individëve për të grumbulluar, poseduar dhe disponuar sende, të lirë nga ndërhyrja e shtetit (*shih vendimet nr. 21, datë 18.04.2023; nr. 29, datë 02.07.2021; nr. 14, datë 21.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*), Gjykata evidenton se mosekzekutimi i këtij detyrimi mund të prekë edhe këtë liri, për sa kohë që pasojat mund të jenë të tilla që mund të çojnë deri në falimentimin e kërkueses, duke prekur kështu vetë thelbin e kësaj lirie. Për rrjedhojë, Gjykata konstaton se vendimet e kundërshtuara kanë ndërhyrë, në thelb, në të drejtën e pronës, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës.

23. Për sa u përket pasojave të ardhura në këtë të drejtë, në drejtim të mundësisë së riparimit të këtyre pasojave gjatë procesit të themelit, Gjykata, bazuar edhe në praktikën e GJEDNJ-së, vëren se procedurat paraprake, siç janë ato që kanë të bëjnë me dhënien e një mase të përkohshme, edhe pse si rregull nuk përcaktojnë të drejta dhe detyrime civile, ndodh shpesh që ato të vendosin, njësoj si vendimet e themelit, të njëjtat “të drejta ose detyrime civile” dhe të kenë të njëjtat efekte që zgjasin në kohë ose edhe të përhershme në lidhje me të drejta ose detyrimeve civile (*shih vendimin nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata, siç ka konstatuar edhe më sipër, vëren se çështja konkrete në shqyrtim lidhet me ekzekutimin e detyrimeve monetare që kanë lindur nga kontrata e lidhur rregullisht mes kërkueses dhe DPPSH-së, kontratë e cila ka forcën e ligjit për to në kuptim të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative dhe të Kodit Civil, ndërsa faturat tatimore të shitjes që lëshohen gjatë zbatimit të saj cilësohen nga ligji i posaçëm (*ligji nr. 48/2014*) si tituj ekzekutivë. Gjykata vëren se në vendimet e kundërshtuara nga kërkuesja, gjykatat e zakonshme kanë disponuar për pezullimin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë sipas urdhrin gjyqësor të ekzekutimit, por nuk kanë përcaktuar as ndonjë kohë dhe as ndonjë ngjarje konkrete kur efektet e pezullimit mbaronin. Nga ana tjetër, në pjesën arsyetuese të vendimeve, ndonëse vlerësimin e tyre për pezullimin e ekzekutimit e kanë lidhur me procesin e parë gjyqësor (atë në lidhje me pavlefshmërinë e titujve ekzekutivë), i cili ndodhej në gjykatën e apelit, gjykatat e zakonshme kanë evidentuar si fakte relevante edhe procesin e dytë gjyqësor (atë për kundërshtimin e veprimit përmbartimor të përlllogaritjes së kamatëvonesave ligjore), i cili ndodhej në gjykatën e shkallës së parë, sikundër edhe pretendimet e debitorit për veprime të tjera përmbartimore ende të pakundërshtuara nga ai në gjykatë. Parë në këtë këndvështrim, duket se vendimet për pezullimin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë në rastin konkret janë të paqarta për sa i përket kohëzgjatjes së pezullimit dhe hipotetakisht mund të interpretohen se pezullimi mbulon çdo proces gjyqësor të vënë apo që mund të vihet në lëvizje nga debitori në funksion të mbrojtjes nga ekzekutimi. Për rrjedhojë, ndërhyrja në ekzekutimin e detyrimeve monetare në favor të kërkueses përmes vendimit të pezullimit në rastin konkret tashmë po vijon prej më shumë se 15 muaj, ndërkohë që duket se do të vijojë edhe për një periudhë tjetër të papërcaktuar kohe. Nisur nga kjo, efektet e këtij vendimi rezultojnë të kenë një ndikim të konsiderueshëm në të drejtën substanciale të pronës së kërkueses, pavarësisht rezultatit ose rezultateve të proceseve gjyqësore për themelin e pretendimeve të debitorit.

25. Në këto rrethana vendimi i pezullimit është bërë objekt kundërshtimi në të gjitha shkallët e juridiksionit të zakonshëm, duke sjellë pasoja të drejtpërdrejta e të konsiderueshme ndaj të drejtave të kërkueses. Duke pasur parasysh konsideratat e mësipërme se pasojat në të drejtat e kërkueses vijojnë për një kohë të papërcaktuar deri në marrjen e një vendimi përfundimtar dhe për më tepër që riparimi i këtyre të drejtave gjatë procesit të themelit është i pamundur, për sa kohë nuk është identifikuar vetë procesi i themelit me të cilin lidhet masa, Gjykata çmon se vendimi i kundërshtuar plotëson dukshëm kriterin e autonomisë. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se vendimet objekt i këtij gjykimi kushtetues përmbushin standardet kushtetuese për t'u konsideruar përfundimtare për efekt të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të

Kushtetutës. Për rrjedhojë, kërkesja e plotëson dhe kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion, ndaj pretendimi i subjektit të interesuar DPPSH-së edhe në këtë drejtim është i pabazuar.

26. Në vijim, Gjykata do të verifikojë edhe kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive që lidhen me përmbajtjen e pretendimeve të kërkueses, i cili në aspektin formal të tij kërkon që pretendimet që parashtrohen përpara kësaj Gjykate të jenë paraqitur më parë në gjykatat e zakonshme, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata vëren se pretendimin për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit nga Gjykata Administrative e Apelit dhe argumentet mbi të cilat e mbështet atë, kërkesja i ka parashtruar për herë të parë në ankimin kushtetues individual, pa i ngritur më parë në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim. Për sa u përket pretendimeve të tjera të parashtruara nga kërkesja, Gjykata vëren se ajo i ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit, duke i parashtruar më parë ato në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë.

27. Kërkesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 21.11.2023, i cili i është njoftuar kërkueses nëpërmjet postës elektronike në datën 22.01.2024, ndërsa ankimi kushtetues është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 22.05.2024, pra brenda afatit 4-mujor nga data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin e kundërshtuar.

28. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, kërkesja ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, për shkak të gjykimit të çështjes në dhomën e këshillimit, çka, sipas saj, e ka vënë në pamundësi që të mbrohej. Në këtë aspekt, Gjykata rithekson se shqyrtimi i rekursit në dhomën e këshillimit, mbi bazë të dokumenteve dhe pa praninë fizike të palëve, nuk do të thotë se ato (palët) nuk janë dëgjuar (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Për më tepër, Gjykata konstaton se ka qenë vetë kërkesja që e ka vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë, nëpërmjet rekursit të veçantë, ku ka parashtruar pretendimet e saj në lidhje me vendimmarrjen e Gjykatës Administrative të Apelit, të cilat janë marrë në shqyrtim nga Gjykata e Lartë duke u vlerësuar si të pabazuara. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkueses është haptazi i pabazuar.

29. Gjithashtu, kërkuesja ka pretenduar, në thelb, cenimin e së drejtës së pronës, si pasojë e zhvillimit të një procesi jo të rregullt, në aspektet e parimit të sigurisë juridike dhe së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhura me standardin e arsytimit. Këto pretendime të kërkueses janë të tilla që *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues.

30. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se në rastin përjashtimor të kontrollit të vendimeve që vendosin masa me karakter të ndërmjetëm, ndërsa ajo i trajton pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues në drejtim të të drejtave substanciale, pretendimet që kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt trajtohen si aspekte procedurale të së drejtës substanciale të pretenduar të cenuar. Në këtë kuptim, Gjykata ndalet në aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjykata, duke pasur parasysh se pretendimet e kërkueses lidhen me një të drejtë substanciale siç është ajo e pronës, si një e drejtë që nuk mund të rikuperohet gjatë procesit të themelit të çështjes, si dhe duke mbajtur parasysh edhe pretendimet në drejtim të procesit të rregullt në procesin gjyqësor të kundërshtuar, të cilat kanë sjellë praktikisht cenimin e së drejtës substanciale, Gjykata çmon ta shqyrtojë çështjen në vijim në drejtim të kësaj të drejte, si në aspektin procedural, lidhur me garancitë për një proces të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës, ashtu edhe në aspektin substancial, lidhur me kriteret që e lejojnë kufizimin e saj, sipas nenit 41 të Kushtetutës. Për sa i përket aspektit procedural, duke pasur parasysh natyrën e pretendimeve të kërkueses, Gjykata vlerëson t'i shqyrtojë ato në këndvështrim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me parimin e sigurisë juridike dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

32. Kurse në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, për shkak se Gjykata e Lartë e ka trajtuar kërkuesen ndryshe nga çka trajtuar palë të tjera në raste të ngjashme dhe se në rastin e saj ka tentuar ta klasifikojë çështjen si kërkesë për sigurim padie sipas neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 49/2012, ndërkohë në një rast tjetër ajo gjykatë ka mbajtur qëndrimin se kjo përbën cenim të kompetencës lëndore, Gjykata vlerëson që ky pretendim, për nga natyra dhe përmbajtja e tij, të trajtohet bashkë me pretendimet e tjera të kërkueses të lidhura me aspektin procedural të së drejtës së pronës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës substanciale së pronës

B.1.1. Për aspektin procedural të së drejtës së pronës

33. Kërkuësja ka pretenduar, në thelb, se gjykatat nuk kanë saktësuar nëse çështja ka të bëjë me sigurimin e padisë në gjykimin administrativ, që shqyrtohet sipas neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 49/2012, të cilat janë *lex specialis* për nenet 202 e vijues të KPC-së apo me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv dhe kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, që rregullohen nga nenet 609 dhe 610 të KPC-së, duke mos përcaktuar qartë bazën ligjore të vendimmarrjes. Sipas kërkuëses, në rastin konkret nuk jemi thjesht përpara një vendimi të formës së prerë, por edhe përpara një gjykimi që lidhet me lëshimin e urdhrin të ekzekutimit. Kërkuësja ka pretenduar, gjithashtu, mungesën e arsytimit të gjykatave në drejtim të kriterëve që duhet të përmbushen rast pas rasti për pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv si një mjet i jashtëzakonshëm. Sipas saj, gjykatat duhet të kishin arsyetuar përse dëmi është i pakthyeshëm, në rastin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv, përse cenohet interesi publik dhe përse kërkuësja, nëse do të rezultonte gjyqumbëse, nuk ka kapacitete për të kthyer mbrapsht shumat monetare etj., duke e lidhur arsyetimin me rrethanat e kërkuëses dhe marrëdhënien konkrete kontraktore. Sipas kërkuëses, nenet 28 dhe 29 të ligjit nr. 49/2012 synojnë të mbrojnë individin ndaj shtetit dhe jo të kundërtën. Sipas kërkuëses, Gjykata e Lartë në rastin e saj ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga ai në raste të tjera ku i ka konsideruar sigurimin e padisë dhe pezullimin e ekzekutimit të një titulli ekzekutiv si koncepte të ndryshme që nuk njësohen me njëra-tjetrën.

34. Subjekti i interesuar, DPPSH-ja, ka parashtruar se pretendimet e kërkuëses janë haptazi të pabazuara, pasi forma e arsytimit të Kolegjit Administrativ shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit gjatë shqyrtimit paraprak në dhomën e këshillimit dhe nuk paraqet ndonjë mangësi, e cila ka ndikuar negativisht në të drejtën e kërkuëses për proces të rregullt ligjor. Sipas DPPSH-së, vendimi i mospranimit të rekursit nga Gjykata e Lartë ndaj vendimit për pezullimin e veprimeve përmbarimore është i arsyetuar në zbatim të drejtë të ligjit dhe në përputhje me të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe parimin e sigurisë juridike.

35. Sipas neni 42 të Kushtetutës, prona, ashtu si dhe të drejtat dhe liritë e tjera, nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Në drejtim të së drejtës për proces të rregullt, e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj përfshin edhe kompetencën lëndore të gjykatës, si një kriter përcaktues i gjykatës që do të vendosë për çështjen dhe i procedurës gjyqësore që do të ndjekë gjykimi konkret. Në përputhje me këtë, ligji ka parashikuar verifikimin e kompetencës lëndore për shqyrtimin e çështjes me kërkesë të palëve ose me nismë

të vetë gjykatës, pra nëse ajo është kompetente në lëndë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së paraqitur (*shih vendimin nr. 3, datë 07.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se respektimi rigoroz i ligjit përbën detyrim për Gjykatën e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, për sa kohë ajo ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 26, datë 09.04.2024; nr. 29, datë 01.11.2022; nr. 16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Në drejtim të së drejtës për proces të rregullt, e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj përfshin edhe kompetencën lëndore të gjykatës, si një kriter përcaktues i gjykatës që do të vendosë për çështjen dhe i procedurës gjyqësore që do të ndjekë gjykimi konkret. Në përputhje me këtë, ligji ka parashikuar verifikimin e kompetencës lëndore për shqyrtimin e çështjes me kërkesë të palëve ose me nismë të vetë gjykatës, pra nëse ajo është kompetente në lëndë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së paraqitur. Thelbësore në përcaktimin e kompetencës lëndore është identifikimi i natyrës së mosmarrëveshjes, konkretisht objekti dhe shkak i ligjor i saj. Këtij rregulli i nënshtrohen gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, të cilat duhet të zbatojnë përcaktimet ligjore materiale dhe procedurale për organizimin dhe funksionimin e tyre (*shih vendimin nr. 3, datë 07.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Për sa i përket standardit të arsytimit të vendimeve gjyqësore, si element tjetër i së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt, Gjykata ka theksuar se funksioni i një vendimi të arsytuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 51, datë 20.06.2024; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket vendimeve të Gjykatës së Lartë, edhe pse detyrimi për garantimin e këtij standardi nuk nënkupton se kërkohet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, Gjykata ka theksuar se kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, ajo gjykatë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në shqyrtimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 51, datë 20.06.2024; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Nga ana tjetër, parimi i sigurisë juridike, ashtu si edhe mbrojtja e të drejtave të fituara dhe pritshmërive të ligjshme, përbëjnë elemente të parimit të shtetit të së drejtës të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 1, datë 25.01.2024; nr. 1, datë 16.01.2017; nr. 25, datë 28.04.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i sigurisë juridike,

ndërmjet të tjerash, garanton qëndrueshmërinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si edhe besueshmërinë e individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike lidhet me faktin se kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Pra, kur vendimi ka marrë formë të prerë, ai është i detyrueshëm edhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera (*shih vendimin nr.2, datë 29.01.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Për të drejtat e fituara, si element i parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara, nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të “procesit të rregullt”, përderisa diskutohet e vendoset lidhur me këto të drejta të fituara. Ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi ku pretendohet cenimi i të drejtave të fituara dhe siguria juridike që rrjedh prej tyre (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 10, datë 13.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Gjykata ka theksuar se me qëllim shqyrtimin e çështjeve kushtetuese, ajo vlerëson vetëm ato fakte që janë të përcaktuara nga gjykatat e zakonshme dhe që përbëjnë fakte të natyrës kushtetuese, mbi bazën e të cilave vlerësohet respektimi i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, pasi qëllimi i saj nuk është që të kthehet në një gjykatë të shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme (*shih vendimin nr. 53, datë 31.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Nën dritën e garancive të mësipërme, si duke pasur parasysh natyrën dhe thelbin e pretendimeve të kërkuases, Gjykata do të vlerësojë në vijim nëse në rastin konkret gjykatat administrative, në zbatimin dhe interpretimin e dispozitave ligjore, kanë respektuar si kompetencën e tyre për të shqyrtuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit, ashtu edhe standardin e arsyetimit të vendimeve të tyre në këtë drejtim. Më konkretisht, Gjykata do të verifikojë nëse baza ligjore, përkatësisht neni 28 i ligjit nr. 49/2012 i lidhur me nenet 202-209 të KPC-së, e lejon gjykatën e apelit që të vendosë për marrjen e masës së pezullimit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv në kuptim të neneve 609 dhe 610 të KPC-së. Po ashtu, Gjykata do të verifikojë nëse gjykatat e zakonshme kanë mundësi të shqyrtojnë dhe të vendosin për marrjen e masës së pezullimit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv jashtë apo përtej një procesi gjyqësor konkret themeli, si edhe nëse ato në rastin konkret kanë parashtruar mjaftueshëm argumente për këto aspekte. Ndërsa, në lidhje me Gjykatën e Lartë, duke pasur parasysh natyrën e pretendimeve të ngritura në rekurs, Gjykata, në vijim, do të verifikojë nëse ajo gjykatë ka luajtur rolin e saj si gjykatë ligji dhe nëse ka vepruar në respektim të parimit të subsidiaritetit.

41. Gjykata konstaton se ligji i posaçëm nr. 49/2012 parashikon se ky gjykim është treshkallësh, duke përcaktuar edhe kompetencat funksionale për gjykatat e secilës shkallë. Në nenin 10 të tij, ligji ka përcaktuar se mosmarrëveshjet administrative të parashikuara në nenin 7, me përjashtim të atyre që lidhen me aktin nënligjor normativ, janë në kompetencën funksionale të gjykatave administrative të shkallës së parë, kurse në kompetencën funksionale të Gjykatës Administrative të Apelit janë ankimet kundër vendimeve të gjykatës administrative të shkallës së parë. Po ashtu, janë në kompetencën funksionale të Gjykatës Administrative të Apelit edhe mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative, si dhe çdo rast tjetër i parashikuar me ligj, ku ajo vepron si gjykatë e shkallës së parë. Ligji, po ashtu, ndërsa ka rregulluar shqyrtimin gjyqësor në shkallë të parë, në nenin 28 të tij ka rregulluar edhe sigurimin e padisë, duke parashikuar mundësinë e paditësit që, me paraqitjen e padisë ose edhe përpara ngritjes së saj, t'i kërkojë gjykatës marrjen e masave për sigurimin e padisë, duke parashikuar po ashtu kjo dispozitë edhe kriteret për vendosjen e kësaj mase nga gjykata, sikundër edhe afatet dhe formën e shqyrtimit prej saj të kërkesës. Po ashtu, dispozita në fjalë ka parashikuar mundësinë e dhënies së vendimit për sigurimin e padisë edhe në çdo shkallë të shqyrtimit gjyqësor, derisa vendimi nuk ka marrë formë të prerë, vendim i cili jepet nga gjykata pranë së cilës ndodhet padia. Ndërkohë, ligji nuk rregullon shprehimisht pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Megjithatë, neni 1, pika 2, i ligjit parashikon se dispozitat e tij plotësohen me parashikimet e KPC-së, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe.

42. Në vijim, Gjykata konstaton se ligji procedural civil dallon masat e përkohshme që mund të vendosen nga gjykata në një gjykim të zakonshëm, nga ato që mund të vendosen në një gjykim që lidhet me ekzekutimin e titujve ekzekutivë. Kështu, neni 203 i KPC-së, pjesë e institutit të sigurimit të padisë, në pikën 2 të tij përcakton se: *“Sigurimi i padisë nuk lejohet në rastet e padive që ngrihen gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit, për të cilat zbatohet pjesa e katërt e këtij Kodi”*. Ndërkohë në këtë të fundit rregullohet ekzekutimi i detyrueshëm, duke përfshirë edhe mjetet mbrojtëse nga ekzekutimi, ndër to pavlefshmëria e titullit ekzekutiv (neni 609) dhe kundërshtimi i veprimeve përmbaremore (neni 610), procedura gjyqësore gjatë të cilave, gjykata e shkallës së parë, me kërkesë të palëve, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit. Për sa i përket vendimit të gjykatës për pezullimin ose jo të ekzekutimit në një procedurë gjyqësore për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, ligji (neni 609, paragrafi 4) ka parashikuar mundësinë e ankimit (të veçantë) në gjykatën e apelit, kurse në një procedurë gjyqësore për kundërshtimin e veprimeve përmbaremore, ligji (neni 610, paragrafi 6) parashikon në mënyrë të përgjithshme mundësinë e ankimit të vendimit të gjykatës së shkallës

së parë pa bërë dallim midis këtij lloji vendimi dhe atij për themelin e çështjes. Gjithsesi, ligji përcakton se shqyrtimi nga gjykata i kundërshtimit të veprimeve përmbarimore bëhet brenda 20 ditëve. Nga ana tjetër, ligji procedural civil, në pjesën e katërt, nuk ka parashikuar kritere për vendosjen nga gjykata të pezullimit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Megjithatë, për vendime të kësaj natyre, kritere të tilla gjenden në dispozita të tjera të ligjit, konkretisht në nenet 497 dhe 500, që bëjnë fjalë respektivisht për pezullimin e ekzekutimit të vendimit në kuadër të shqyrtimit të rekursit nga Gjykata e Lartë dhe për pezullimin e ekzekutimit të vendimit në kuadër të shqyrtimit nga gjykata kompetente të kërkesës për rishikim. Në thelbin e tyre, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit këto dispozita konsiderojnë mundësinë e ardhjes së pasojave të rënda dhe të pariparueshme nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit dhe/ose dhënien nga gjyqumbësi (debitori) të garancive materiale që sigurojnë ekzekutimin e vendimit.

43. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se kërkesa për pezullimin e ekzekutimit është bërë nga debitori drejtpërdrejt në Gjykatën Administrative të Apelit. Këtë kërkesë ai e ka lidhur qoftë me procesin e parë gjyqësor që ndodhej në atë gjykatë, ashtu edhe me procesin e dytë gjyqësor që ndodhej në gjykatën e shkallës së parë, sikundër edhe me pretendime për veprime të tjera përmbarimore të pakundërshtuara ende në gjykatë. Gjykata Administrative e Apelit e ka shqyrtuar kërkesën, duke arsyetuar se kompetencën e merrte nga neni 28 i ligjit nr. 49/2012, ndërsa për themelin e kërkesës u referohej neneve 609 dhe 610 të KPC-së. Duket se ajo gjykatë kërkesën e debitorit në rastin konkret e ka konsideruar si kërkesë për sigurim padie, por, megjithatë, në përfundim ajo nuk ka vendosur për marrjen e ndonjë mase sigurimi padie, por për pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Referuar masës së vendosur, një masë e tillë është refuzuar nga gjykata e shkallës së parë qoftë në procesin e parë gjyqësor (atë për pavlefshmërinë e titujve ekzekutivë), ashtu dhe në procesin e dytë gjyqësor (atë për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore), ndërkohë që Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka shqyrtuar çështjen mbi bazën e ndonjë ankimi (të veçantë) ndaj atyre vendimeve, përveçse procesi i dytë gjyqësor vijonte të ishte në shkallë të parë. Gjithashtu, po referuar masës së vendosur, për sa u përket kundërshtimeve të tjera të debitorit ato ende nuk ishin ngritur në gjykatë përmes përdorimit nga ai të mjetit përkatës mbrojtës. Për rrjedhojë, duket se kërkesa e debitorit për pezullimin e ekzekutimit është shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit (i) si një kërkesë që mund t'i paraqitej edhe asaj për herë të parë, (ii) pavarësisht nëse ajo lidhej ose jo me një ose disa procese gjyqësore, (iii) si dhe pavarësisht se ku ato procese ndodheshin.

Megjithatë, ajo gjykatë nuk ka arsyetuar për secilin nga këto aspekte në raport me kompetencën funksionale të saj sipas rregullimeve të ligjit procedural.

44. Gjykata vëren, gjithashtu, se Gjykata Administrative e Apelit ka disponuar për pezullimin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë duke mos e lidhur atë me një proces gjyqësor konkret. Ligji procedural lejon pezullimin e ekzekutimit në kuadër të një procesi gjyqësor të caktuar, duke përcaktuar në këtë mënyrë dhe natyrën e përkohshme të kësaj mase.

45. Po kështu, Gjykata konstaton se edhe Gjykata e Lartë, ndonëse në rekursin e kërkueses janë ngritur pretendime për këto aspekte të procesit gjyqësor të zhvilluar nga Gjykata Administrative e Apelit, si dhe pavarësisht se ajo mund t'i marrë në shqyrtim edhe kryesisht çështjet e kompetencës (funksionale dhe lëndore), ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses me arsyetimin se shkaqeve të ngritura në të u është dhënë përgjigje shteruese nga Gjykata Administrative e Apelit, megjithëse kërkuësja nuk ka qenë pjesë e shqyrtimit në apel dhe, në këtë kuptim, nuk i ka parashtruar asaj gjykate ndonjë pretendim të kësaj natyre. Nga ana tjetër, në arsyetimin e kufizuar të saj, Gjykata e Lartë, njëlloj si dhe Gjykata Administrative e Apelit, ka vlerësuar se kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv, në thelb, përbën kërkesë për marrjen e masës së sigurimit të padisë gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv, ndaj në këto raste zbatoheshin me analogji kushtet ligjore për sigurimin e padisë të parashikuara në nenin 29 të ligjit nr. 49/2012. Megjithatë, ajo gjykatë nuk ka arsyetuar për barazimin e këtyre dy mjeteve në raport me parashikimet ligjore në këtë drejtim dhe aq më tepër, në kuadër të parimit të subsidiaritetit, ajo nuk ka vënë në diskutim dhe mbajtur qëndrim të shprehur për ato aspekte të ligjit të evidentuara më lart në raport me rrethanat e rastit konkret. Duke vepruar në këtë mënyrë Gjykata e Lartë nuk ka ushtruar rolin e saj si gjykatë ligji.

46. Për sa i përket arsyetimit të vendimeve të kundërshtuara në lidhje me arsyet e vendosjes së masës së pezullimit të ekzekutimit, Gjykata mban parasysh se në rastin konkret ndodhemi përpara disa akteve (fatura tatimore shitjeje) që përmbajnë detyrime monetare, për të cilat gjykata, në një proces për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, ka vlerësuar se kanë lindur nga një veprim juridik tregtar, kontrata në të cilën debitori është autoritet publik dhe që për këtë arsye ato akte janë tituj ekzekutivë në kuptim të ligjit nr. 48/2014, qëllimi i të cilit është të sigurojë funksionimin e duhur të tregut të brendshëm, duke nxitur aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve tregtare dhe, në veçanti, të ndërmarrjeve të vogla e të mesme. Nisur nga kjo, ndonëse vlefshmëria dhe ligjshmëria e ekzekutimit të titujve ekzekutivë në rastin konkret është vënë në diskutim nga debitori, Gjykata vëren se vendosja nga gjykatat e masës së pezullimit të

ekzekutimit, ndërsa ndërhyr në të drejtat e kreditorit, lidhet edhe me parimin kushtetues të sigurisë juridike në drejtim të pritshmërive të ligjshme. Nisur nga kjo, vetëm ngritja e pretendimeve para gjykatës në drejtim të vlefshmërisë së titullit ekzekutiv dhe/ose të ligjshmërisë së ekzekutimit të tij nuk përbën, në kuptim të ligjit, shkak pengues për ekzekutimin, ndaj pezullimi i ekzekutimit nga gjykatat është rast përjashtimor dhe, si i tillë, duhet të argumentohet nga ato në përputhje me kriteret e përcaktuara nga ligji, duke mbajtur në konsideratë se një masë e tillë, ndërsa synon mbrojtjen e të drejtave të debitorit, nuk përjashton mbrojtjen e të drejtave të kreditorit dhe as zhbërjen e tyre. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se në këto raste, gjykatat duhet të tregojnë një kujdes të shtuar për arsyetimin e vendimeve që vendosin pezullimin e ekzekutimit, duke shmangur përdorimin e arsyetimeve standarde dhe të kufizuara. Të njëjtin kujdes duhet të tregojnë ato në rastin kur kanë vendosur pezullimin e ekzekutimit edhe për përfundimin në një kohë të arsyeshme të procesit gjyqësor të themelit, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të garantohet proporcionaliteti i ndërhyrjes në të drejtat e kreditorit në aspektin e përkohshmërisë së saj.

47. Në rastin konkret Gjykata vëren se gjykata e apelit, për sa u përket arsyeve për vendosjen e masës së pezullimit të ekzekutimit, u është referuar kushteve për sigurimin e padisë. Në këtë mënyrë është e dukshme se ajo gjykatë, pavarësisht mjetit që e ka vënë në lëvizje, nuk u është referuar kushteve të parashikuara nga ligji për atë mjet, por një mjet tjetër, mjete këto që në fakt duket se përfaqësojnë dy institute të ndryshme të së drejtës procedurale civile, të cilat, pavarësisht ngjashmërive si masa me karakter të përkohshëm, dallojnë për nga përmbajtja dhe për nga natyra e tyre juridike. Në këtë kuptim, duke qenë se pretendimet e kërkuases të parashtruara në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë ishin sa me natyrë ligjore po aq edhe kushtetuese, Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit dhe duke mos u dhënë përgjigje përfundimtare atyre pretendimeve, jo vetëm që nuk ka përmbushur detyrimin e saj si gjykatë ligji, por nuk ka vepruar as në respektim të parimit të subsidiaritetit.

48. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se Gjykata Administrative e Apelit nuk ka parashtruar mjaftueshëm argumente në lidhje me kompetencën e saj funksionale për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga subjekti i interesuar, DPPSH-ja, sikundër edhe për vendosjen e masës së pezullimit të ekzekutimit. Nga ana tjetër, edhe Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar në këtë drejtim, duke mos ushtruar ajo rolin e saj si gjykatë ligji. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se ishte detyrë fillimisht e gjykatës së apelit të arsyetonte në drejtim të kompetencës së saj në rastin konkret apo pranisë së rasteve përjashtimore që do të lejonin atë në shqyrtimin e një kërkesë të tillë, ashtu edhe pranisë së kriterëve që lejojnë vendosjen e një mase të tillë dhe, më

tej, e Gjykatës së Lartë që të verifikonte, në ushtrim të funksionit të saj, mënyrën se si gjykata e apelit ka identifikuar, interpretuar dhe zbatuar dispozitat e zbatueshme, dhe në këtë mënyrë t'u jepte përgjigje edhe pretendimeve të kërkuases të parashtruara në rekurs.

B.1.2. Për aspektin substancial të së drejtës së pronës

49. E drejta e pronës private, e parashikuar në nenin 41 të Kushtetutës, përbën një ndër aspektet më thelbësore të shoqërisë demokratike, si e drejtë universale e njeriut, dhe në një shtet demokratik individit duhet t'i garantohet gëzimi i qetë dhe pa pengesa të paarsyeshme ose joproporcionale i kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 36, datë 21.04.2017; nr. 25, datë 28.04.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). E drejta e pronës private mbrohet edhe nga neni 1 i Protokollit nr.1 të KEDNJ-së, sipas të cilit çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit të qetë të pasurisë së tij dhe askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Kjo dispozitë përfshin tri garanci që duhet të zbatohen në shqyrtimin e pretendimeve për cenimin e së drejtës së pronës: garancia e parë, e cila ka natyrë të përgjithshme, vendos parimin e gëzimit të qetë të pronës; garancia e dytë ka të bëjë me kufizimet e lejueshme mbi të drejtën e pronës; garancia e tretë u njeh shteteve, ndërmjet të tjerash, të drejtën për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm (*shih vendimin nr. 53, datë 31.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

50. Gjykata vlerëson se në situatën që ajo arriti në përfundimin se gjykatat e zakonshme nuk kanë respektuar garancitë kushtetuese që lidhen me aspektet procedurale të së drejtës së kërkuases, gjatë procesit gjyqësor të kundërshtuar, në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, mënyra se si kanë vepruar ato në rastin konkret është e mjaftueshme për të vënë në dyshim vetë aspektin substancial të kësaj të drejte në këndvështrim të nenit 41 të Kushtetutës. Duke mbajtur parasysh parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të zakonshëm gjyqësor, si dhe duke pasur parasysh se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, Gjykata çmon se i takon kësaj të fundit, në përputhje me funksionin e saj si gjykatë e ligjit, që të shqyrtojë çështjen në përputhje me pretendimet e kërkuases, në këndvështrim të së drejtës së pronës private dhe standardeve të procesit të rregullt.

51. Gjykata vëren se kërkuësja ka kërkuar në objektin e kërkesës edhe shfuqizimin e vendimit nr. 172, datë 04.07.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit. Në lidhje me këtë kërkim, në përfundim të diskutimeve, Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për

vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000.

52. Sipas njërës qëndrim, shkelja ka ndodhur në gjykatën e apelit dhe ndaj nuk ka nevojë që ajo të korrigjohet nga Gjykata e Lartë. Për sa kohë që në rastin konkret shkelja ka të bëjë me të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, vendimi i gjykatës së apelit duhej shfuqizuar duke mos e kthyer më çështjen për gjykim¹.

53. Sipas qëndrimit tjetër, në rastin konkret është e mundur dhe i takon Gjykatës së Lartë, në ushtrim të rolit të saj si gjykatë ligji dhe bazuar në parimin e subsidiaritetit, që të verifikojë pretendimet e kërkuases në lidhje me interpretimin e ligjit, duke i garantuar respektimin e standardeve kushtetuese gjatë ushtrimit të kontrollit të vendimmarrjes së gjykatës më të ulët².

54. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuases për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe parimit të sigurisë juridike lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-4875, datë 21.11.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.
4. Rrëzimin e kërkesës për kërkimin tjetër.

¹ Gjyqtarët Holta Zaçaj, Sonila Bejtja, Sandër Beci dhe Genti Ibrahimimi votuan për pranimin tërësisht të kërkesës, duke u shfuqizuar edhe vendimi nr. 172, datë 04.07.2023 i Gjykatës Administrative të Apelit.

² Gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Ilir Toska dhe Marjana Semini votuan për rrëzimin e kërimit për shfuqizimin e vendimit nr. 172, datë 04.07.2023 i Gjykatës Administrative të Apelit.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 22.10.2024

Shpallur më 02.12.2024